



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

## **RISHIKIMI I TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE 2008 – PËRGJIGJE NDAJ KOMENTEVE**

**15 Prill 2008**

### **DEKLARATË**

Këto përgjigje janë përgatitur nga ZRRE-ja vetëm për qëllime informative. Ky nuk është dokument vendosës dhe nuk duhet të konsiderohet se përfaqëson ndonjë vendim të ZRRE-së.

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Hyrje</b>	<b>1</b>
<b>2</b>	<b>Përmbledhje e amendamenteve të propozimeve preliminare të ZRRE-së</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	<b>Komentet e KEK-ut</b>	<b>2</b>
3.1	Pamundësia e verifikimit të supozimeve	4
3.2	Krahasimet me të hyrat e lejuara dhe koston e 2007-tës	4
3.3	Trajtimi i humbjeve Komerciale	4
3.4	Përgjashtimi i borxheve të këqija	4
3.5	Reflektimi i kostove të tarifave	5
3.6	Tarifat ditore	5
3.7	Bllok tarifave rritëse	6
<b>4</b>	<b>Komentet e KOSTT-it</b>	<b>6</b>
4.1	Koha e rishikimit të tarifave	7
4.2	Bashkërendimi i të hyrave	7
4.3	Kostoja e ekuivalencës së kapitalit	8
4.4	Përshtatja kompozicionit të të hyrave të lejuara	8
<b>5</b>	<b>Komentet e SHUKOS-it</b>	<b>9</b>
<b>6</b>	<b>Komentet e Shoqatës së Mullisëve të Kosovës</b>	<b>10</b>
<b>7</b>	<b>Shkresë nga MEM-i</b>	<b>11</b>
<b>8</b>	<b>Draft propozimi final tarifar i ZRRE-së</b>	<b>11</b>
8.1	Tarifat me pakicë	11
8.2	Ngarkesat e transmisionit	14

# 1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është duke bërë rishikimin e tarifave elektrike me pakicë që do të vendosen nga KEK SH.A dhe ngarkesat e Transmisionit të aplikuara nga KOSTT SHA<sup>1</sup>. Rishikimi përfshinë të dy nivelet e të hyrave të lejuara për tu rikthyer nga KEK-u dhe KOSTT-i gjatë 2008 nga tarifat e rregulluara dhe ngarkesat si dhe strukturat e atyre tarifave dhe ngarkesave.

Ne raportin konsultativ të publikuar më **10 Mars 2008**, ZRRE-ja ka paraqitur analizën e saj të aplikimit të tarifave të pranuar nga KEK-u dhe KOSTT-i si dhe propozimet preliminare për tarifat e reja. Këto kanë qenë:

- Ngarkesat për energji dhe kërkesat janë rritur në mesatare për 5% për të gjithë konsumatorët.
- Ngarkesat fikse për konsumatorë janë rritur për një numër të madh konsumatorësh që përfaqësojnë koston më të madhe të njehsimit, faturimit dhe arkëtimit për këta konsumatorë.
- Ngarkesat për energji reaktive janë barazuar për të gjitha kategoritë e konsumatorëve sipas normës së aplikuar paraprakisht për konsumatorët e kategorisë 0.4 kV (kategoria e 3-të tarifore) prej €c1.53/kVArh.

Palët e interesuara janë ftuar që të paraqesin komentet me shkrim lidhur me analizat e ZRRE-së, propozimet preliminare dhe të gjitha çështjet tjera lidhur me to. Që nga 20 Marsi 2008-afati i fundit për paraqitjen, komentet janë pranuar nga :

- KEK-u
- KOSTT-i
- "SHUKOS"-i (Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimit të Kosovës)
- Shoqata e Mullisëve të Kosovës

ZRRE falënderon të gjithë prej tyre.

Kopjet e shkresave të tyre mund të shihen në ueb-faqen e ZRRE-së([www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)).

ZRRE gjithashtu ka marrë një shkresë nga Ministria e Energjetikës dhe Minierave (MEM) që paraqet qëndrimin e saj mbi principet që propozohen të ndiqen gjatë rishikimit të tarifave. Në këtë shkresë janë përfshirë KEK-u, KOSTT-i dhe ZRRE-ja. Pjesët relevante që janë të ndërlidhura me vendimmarrjen e ZRRE-së janë integruar në pjesën përkatëse të kësaj shkrese. Kjo shkresë-përgjigje ofron një përmbledhje të komenteve të pranuar si dhe përgjigjen e ZRRE-së ndaj tyre. Po ashtu shpjegon modifikimet tjera të propozimeve preliminare të ZRRE-së. Mëpastaj kjo paraqet draft

---

<sup>1</sup> Operatori i pavarur i sistemit të transmisionit të Kosovës si dhe operatori i tregut me shumicë të energjisë(KOSTT)

propozimet finale të ZRRE-së për tarifatat e reja me pakicë si dhe ngarkesat e transmisionit për 2008. ZRRE do të marrë vendimin final mbi tarifatat e aprovuara pas rishikimit të mëtutjeshëm të këtyre propozimeve nga Bordi i saj. Është qëllim i ZRRE-së që të fillojë aplikimin e tarifave të reja që nga 1 Prilli 2008. Megjithatë, mund të mos jetë e mundur të lëshohet vendimi deri në këtë datë për shkak të mungesës aktuale të kuorumit në Bord<sup>2</sup>.

## **2 Përmbledhje e amendamenteve të propozimeve preliminare të ZRRE-së**

Bazuar në Komentet e pranuar si dhe rishikimin e mëtejshëm interne të të hyrave të lejuara, ZRRE propozon që të bëhen tri amendamente në propozimet e saj preliminare:

1. Humbjet teknike të lejuara për 2008 janë reduktuar nga 18% në 17.4%--sipas nivelit aktual të raportuar për 2007.
2. Ngarkesat për Energji për konsumatorët shtëpiak në bllokun e parë të konsumit ( deri 200kWh në muaj) janë rritur për 2.5%, në vend se 5% si në propozimet preliminare të ZRRE-së.
3. Ngarkesat e energjisë reaktive për të gjithë konsumatorët e kualifikuar për këto (kategoritë tarifore 1,2 dhe 3) janë harmonizuar për €c 0.64/kVArh në vend të €c 1.53/kVArh sipas propozimit preliminar të ZRRE-së.

Amendamenti i parë është propozuar bazuar në rivlerësimin nga ZRRE-ja të ndikimeve të pritura në kostot e mirëmbajtjes të kërkuara nga KEK-u si dhe shpenzimeve kapitale për distribucionin e performancës së tij. ZRRE nuk konsideron të arsyeshme që të supozohet që humbjet teknike të rritjes distributive do të rriten nga nivelet aktuale të 2007-tës përkundër rritjeve të dukshme në mirëmbajtjen e lejuar dhe shpenzimet kapitale për punën e distribucionit të tij.

Baza për amendamentin e dytë dhe të tretë të propozuar është përshkruar në pikat përkatëse të kësaj shkrese.

## **3 Komentet e KEK-ut**

Komentet e KEK-ut lidhen me qasjen metodologjike të aprovuar nga ZRRE-ja, përcaktimin e të hyrave të lejuara si dhe ndryshimet e propozuara në strukturën e tarifave me pakicë. Në përgjithësi, komentet kryesore janë:

- KEK-u nuk ka qenë në gjendje të rishikojë arsyeshmërinë e shumë supozimeve të bëra nga ZRRE-ja për shkak të:
  - Komplexitetit dhe përmasave të modelit tarifor me pakicë (MTP) të përdorur në përcaktimin e të hyrave të lejuar dhe tarifave.

---

<sup>2</sup> Sipas Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, së paku 4 anëtarë të Bordit 5 anëtarësh të ZRRE-së duhet të jenë prezent për të arritur kuorumin e duhur. Pa këtë, ZRRE nuk është në gjendje të lëshojë vendim ligjërish valid. Për shkak të dorëheqjeve, Bordi i ZRRE-së momentalisht ka 3 anëtarë dhe dy vende të lira. Anëtarët e rinj të Bordit për të përmbushur këto vende pritet të emërohen në të ardhmen e afërt.

- Përdorimin e vlerave të parallogaritura në shumicën e rasteve.
- Mungesa e dokumentimit të burimeve të disa supozimeve
- KEK-u konsideron që krahasimet mes kostos aktuale dhe të hyrave të lejuara të 2007-tës ndaj të hyrave të lejuara në 2008 janë çorientuese dhe se tarifat duhet të bazohen ekskluzivisht në koston dhe të hyrat për 2008. KEK-u vëren që kjo qasje është marrëveshje paraprake me ZRRE-në.
- KEK-u nuk pajtohet me propozimin nga ZRRE për reduktimin e humbjeve komerciale të supozuara në 2008 dhe gjithashtu konsideron që çdo reduktim nuk do të rezultojë patjetër në rritjen e shitjeve por mund të shkaktojë importe me të ulëta. KEK-u thotë se një proporcion i këtyre humbjeve është asociuar me furnizimin me energji elektrike që nuk janë faturuar në zonat minoritare.
- KEK-u nuk pajtohet me heqjen e humbjeve në arkëtim (borxheve të këqija) nga të hyrat e lejuara. KEK-u thotë se të gjitha kompanitë kanë një nivel të borxheve të këqija dhe në shumicën e rasteve rregullatorët lejojnë ato që të rimerren/mbulohen nga të hyrat tarifore të rregulluara.
- KEK-u konsideron që tarifat e propozuara me pakicë nga ZRRE-ja nuk rrisin reflektimin e kostove në tarifë:
  - ZRRE-ja nuk ka pranuar përshtatjet e propozuara nga KEK-u në ngarkesat e konsumatorëve për konsumatorët më të vegjël (kategoritë tarifore 4,5,6 dhe 8), por i ka pranuar për konsumatorët më të mëdhenj. Kjo nuk përputhet me lëvizjet drejt reflektimit të kostove në tarifë.
  - Aplikimi i një rritjeje uniforme në energji dhe ngarkesë rritëse prej 5% nënkupton se nuk ka reduktim të ndër-subvencionimeve mes kategorive të konsumatorëve.
- KEK-u ka prezantuar dëshmi se tarifat aktuale ditore për konsumatorët më të vegjël nuk mund të aplikohen drejt për shkak se orët e njehsorëve nuk përputhen me kohën aktuale si rezultat i ndërprerjes së furnizimit<sup>3</sup>. KEK-u gjithashtu deklaron që zgjedhja e propozuar nga ZRRE-ja për instalimin e njehsorëve të rinj do të ishte jashtëzakonisht e shtrenjtë.
- KEK-u ka qartësuar që propozimi i tij për ndërrimin e strukturës tarifore tri-vlerëshe për konsumatorët shtëpiak (kategoritë tarifore 5,6 dhe 7) nuk përfshijnë eliminimin e bllok-tarifës por në fakt zëvendësimin e saj me tarifë dy-vlerëshe për të cilën vetëm konsumatorët në nevojë (me asistence sociale) do të kualifikohen.

Përgjigjet e ZRRE-së ndaj secilit koment janë paraqitur në vijim.

---

<sup>3</sup> Njehsorët ekzistues dy tarifor për konsumatorët më të vegjël nuk kanë bateri rezervë. Kështuqë kur furnizimi ndërprehet, orët në këta njehsorë ndalen dhe ristartohen kur të rikthehet furnizimi me rryme elektrike.

ZRRE-ja nuk sheh nevojën e ndërrimit të propozimeve të saj primare mbi tarifatat me pakicë në bazë të këtyre komenteve. Megjithatë, ZRRE ka identifikuar një numër të çështjeve për diskutim të mëtejshëm me KEK-un para rishikimit të ardhshëm të tarifave.

### **3.1 Pamundësia e verifikimit të supozimeve**

Supozimet fillestare të përdorura në MTP (Modeli Tarifor me Pakicë) janë zhvilluar për rishikimin tarifor 2006-07 nga ZRRE-ja dhe KEK-u duke punuar në bashkëpunim me asistencën e konsulences së ZRRE-së të financuar nga Banka Botërore. Konsulenca është mbikëqyrur nga Bordi udhëheqës i përbërë nga përfaqësuesit e KEK-ut, KOSTT-it, ZRRE-së dhe MEM-it.

Gjatë kohës së rishikimit aktual të tarifave, ZRRE-ja ka kërkuar që të dokumentojë të gjitha ndryshimet kryesore të supozimeve dhe të dhënave të përdorura nga MTP. ZRRE gjithashtu ka bërë ndryshime për MTP në mënyrë që të përmirësojë saktësinë dhe qartësinë e përlogaritjeve që janë bërë duke e përdorur modelin përkatës.

ZRRE-ja do të vazhdojë të rishikojë dhe shqyrtojë MTP-në para rishikimit të ardhshëm të tarifave. ZRRE gjithashtu synon të rishikojë supozimet e ndryshme të përdorura në MTP në mënyrë që të azhurojë dhe dokumentojë këto para rishikimit të ardhshëm të tarifave. ZRRE pret që KEK-u të kontribuojë në këtë proces për të siguruar që të gjitha këto supozime janë sa më të sakta, aktuale dhe të qëndrueshme.

### **3.2 Krahasimet me të hyrat e lejuara dhe koston e 2007-tës**

Përcaktimi i ZRRE-së për të hyrat e lejuara për KEK-un gjatë 2008-ës ka qenë i bazuar, sipas marrëveshjes me KEK-un, mbi kostot e vlerësuara për 2008. ZRRE konsideron të vlefshme prezantimin e krahasimeve me të hyrat e lejuara dhe koston e 2007-ës në mënyrë që të ndihmojë palët e interesuara që të kuptojnë faktorët kryesor prapa të gjitha ndryshimeve në të hyrat e lejuara që mbulohen nga tarifatat me pakicë.

### **3.3 Trajtimi i humbjeve komerciale**

ZRRE-ja vëren se humbjet komerciale rrjedhin nga burime të ndryshme. ZRRE-ja pret që reduktimet e këtyre humbjeve do të jenë si pasoje e reduktimeve nga vjedhjet dhe gabimeve në matje në vend se nga reduktimet e energjisë elektrike të pa-faturuar që në fakt përbën vetëm një pjesë të këtyre humbjeve. Masat e tilla janë nën kontrollin e KEK-ut. ZRRE-ja gjithashtu vëren se në përgjithësi do të pritët që reduktimet e vjedhjeve dhe gabimeve të matjes do të konvertohen në shitje të rritur më shumë se në kërkesat e reduktuara për blerjen e energjisë, kërkesa në masë të madhe mbetet e pandryshuar por shitjet tani do të jenë të regjistruara.

### **3.4 Përfshirja e borxheve të këqija**

ZRRE ka vërejtur që principi se humbjet e arkëtimit (borxhet e këqija) janë përjashtuar nga të hyrat e lejuara gjë që është përcaktuar gjatë rishikimit paraprak të tarifave të energjisë elektrike gjatë 2006-07. ZRRE gjithashtu thekson që norma e ulët e arkëtimit e KEK-ut nënkupton që ndikimet e përfshirjes së këtyre humbjeve në të hyrat e lejuara do të jenë shumë të theksuara. Gjatë 2007-ës norma e arkëtimit të KEK-ut ka qenë përafërsisht 75%. Lejimi i humbjeve rezultuese të arkëtimit prej

25% të të hyrave të faturuar për tu përfshirë në tarifatat me pakicë, do të kërkonte që tarifatat me pakicë të rriten për 33% vetëm për këtë arsye.

Një rritje e tarifave me pakicë e këtyre përmasave, që shkaktohet nga nevoja që konsumatorët pagues gjithashtu të paguajnë edhe për energjinë elektrike të konsumuar nga konsumatorët që nuk paguajnë, nuk është e arsyeshme dhe me siguri do të keqësonte problemin ekzistues të arkëtimit. Bartja e humbjeve të arkëtimit në të hyrat e lejuara dhe tarifatat e rregulluara me pakicë gjithashtu do të reduktonte motivin e KEK-ut për të përmirësuar normën e tij të arkëtimit.

Rrjedhimisht ZRRE-ja nuk konsideron të drejtë aktualisht përfshirjen e humbjeve të arkëtimit në të hyrat e lejuara.

ZRRE gjithashtu vëren që çdo dispozitë për rikthimin e borxheve të këqija përmes të hyrave të lejuara duhet të jetë konsistente/në përputhje me principet e përcaktuara me rregulloren e UNMIK-ut 2004/51 mbi tatimin në të Ardhurat e Korporatave. Kjo vetëm lejon borxhet e këqija të shlyhen aty ku janë të pavlera dhe që është më e rëndësishme aty ku ka dëshmi të përpjekjeve të mirëfillta për të rikthyer borxhet e këqija. ZRRE-ja pret që çdo aplikim në të ardhmen për futjen e borxheve të këqija në të hyrat e lejuara do të shoqërohet nga kjo dëshmi.

### **3.5 Reflektimi i kostove të tarifave**

ZRRE-ja vëren që me aprovimin e propozimeve të KEK-ut për ndryshimet në ngarkesat e konsumatorëve në tërësi do të rezultojë që ngarkesat e konsumatorëve për të gjitha kategoritë tarifore të rriten në mënyrë substanciale (psh. Për 170% për konsumatorët shtëpiak në kategorinë tarifore 5). ZRRE-ja brengoset se rritjet aq të mëdha janë regresive kështu që konsumatorët më nivel më të ulët konsumi do të kenë kosto shumë më të lartë totale për njësi të energjisë së konsumuar sesa ata që kanë nivel të lartë të konsumit.

ZRRE gjithashtu vëren që KEK-u ka ofruar dëshmi mbi koston relative të njehsimit, faturimin dhe arkëtimin për kategoritë e ndryshme tarifore po jo në koston absolute të këtyre shërbimeve të përdorura për të derivuar ngarkesat e propozuara të konsumatorëve. Propozimet preliminare të ZRRE-së do të përmbajnë këto ngarkesa relative përveç aty ku këto do të rezultojnë në rezultate të gabueshme. Si, për shembull, ngarkesat e konsumatorëve për kategorinë e parë tarifore (35kV) sipas propozimit preliminar të ZRRE-së do të ishin 5.4 herë më të mëdha se ato për kategorinë 5 (konsumatorët dy-vlerësh shtëpiak). Kjo korrespondon me koston relative të njehsimit, faturimit dhe shërbimeve të arkëtimit të këtyre dy kategorive të konsumatorëve siç i janë ofruar ZRRE-së nga KEK.

### **3.6 Tarifatat ditore**

KEK-u në komentet e tij ka bërë një krahasim mes pjesës së kërkesës së sistemit që përket nën secilën periudhë tarifore dhe pjesës së shitjeve të faturuara për konsumatorët shtëpiak me njehsor dy-vlerësh (kategoria tarifore 5). KEK-u ka vërejtur që pasi kjo kategori tarifore llogaritet për mbi 55% të shitjes së energjisë elektrike me pakicë duhet të pritët që pjesët e llogaritura do të jenë të ngjashme. Megjithatë, në fakt ato janë dukshëm të ndryshme.

ZRRE-ja pranon që njehsorët ekzistues me mundësi matjeje ditore mund të jenë të pasaktë. Megjithatë, ZRRE-ja kupton që KEK-u synon të ushtroj një program të zgjeruar të zëvendësimit të

njehsorëve ekzistues të konsumatorëve. Një lejim për koston e këtij programi është përfshirë në të hyrat e lejuara për KEK-un për 2008-tën. ZRRE-ja paraprakisht ka kërkuar dhe vazhdon të kërkojë që KEK-u të ofrojë dëshmi mbi kostot shtesë të lidhura me prokurimin e njehsorëve të rinj për konsumatorët shtëpiak me mundësi të sakta të matjes ditore në krahasim me njehsorët që nuk e kanë këtë mundësi. Atëherë do të jetë e mundur që ZRRE-ja të përcaktojë se a mbimbuloen këto kosto shtesë nga beneficionet e tarifave ditore në aspekt të motivimit për menaxhim të kërkesës nga konsumatorët.

Në mungesë të kësaj dëshmie, ZRRE nuk konsideron të rregullt aprovimin e përfundimit të tarifave ekzistuese ditore. Një gjë e tillë krijon rrezik që tarifat ditore për konsumatorët më të vegjël së pari të zëvendësohen me tarifa një-vlerëshe të cilat mëpastaj zëvendësohen përsëri nga tarifat ditore. Një rezultat i tillë do të ishte i paqëndrueshëm me tarifat stabile dhe të parashikueshme të energjisë elektrike.

### **3.7 Bllok tarifat rritëse**

ZRRE-ja pranon qartësimin e KEK-ut mbi synimet që ndodhen në ndryshimet e propozuara për bllok tarifat rritëse për konsumatorët shtëpiak. Megjithatë, ZRRE-ja vëren që vazhdon të mbetet i pamundur vlerësimi i ndikimeve të propozimeve të KEK-ut në konsumatorët me një kuptim më të qartë të kriterëve të përdorura për të përcaktuar se a do të jenë të kualifikuar konsumatorët për bllok tarifat rritëse. ZRRE-ja gjithashtu vëren se një kriter i tillë do të duhet të lëshohet para futjes në veprim të tarifave të reja që nënkupton se edhe nëse aprovohen, nuk do të jetë e mundur të aplikohet kjo tarifë nga 1 Prilli 2008.

Momentalisht, ZRRE-ja megjithatë vazhdon të refuzojë propozimin e KEK-ut për të ndryshuar bllok tarifën rritëse. Megjithatë, ZRRE-ja synon të diskutojë me KEK-un paraprakisht rishikimin e ardhshëm tarifor lidhur me kriteret e kualifikimit që mund të aplikohen nën strukturën e propozuar nga KEK-u për tu modifikuar, në bazë të së cilës do të jetë e mundur që të vlerësohet më mirë se a duhet të pranohen këto propozime në të ardhmen.

## **4 Komentet e KOSTT-it**

KOSTT-i ka paraqitur komentet që përfshijnë disa çështje të lidhura me procesin e rishikimit të tarifave dhe të hyrave të lejuara të propozuara si dhe ngarkesave të transmisionit. Prej këtyre, më signifikante janë:

- Një koment së kanë ekzistuar pasiguri të dukshme dhe ndryshueshmëri në periudhën e rishikimit të tarifave deri më sot dhe një kërkesë që të aprovohet orari” i drejtë dhe i qëndrueshëm” për rishikimet e ardhme të tarifave.
- Një kërkesë që periudha në të cilat të hyrat e lejuara janë përcaktuar në rishikimet e ardhshme tarifore është radhitur me vitin financiar në Kosovë (psh. 1 Janar deri 31 Dhjetor)
- Një koment se përkundër Metodologjisë tarifore, të hyrat e lejuara të propozuara nga ZRRE-ja nuk lejojnë për bashkërendimin e dallimeve në mes të hyrave aktuale dhe të lejuara të mbuluara nga KOSTT-i si rezultat i dallimeve mes parashikimit dhe volumeve aktuale të transmetuara. KOSTT-i kërkon që sasinë e harmonizuara tu shtohen të hyrave të lejuara për 2009.

- Një koment që KOSTT-i nuk pranon që kostoja e kapitalit është patjetër e njëjtë mes KEK-ut dhe KOSTT-it, që është e kundërt me supozimet e ZRRE-së.
- Një variacion i kërkuar në komponentët e të hyrave të lejuara nëse shpenzimet operative janë reduktuar dhe zëvendësuar nga rritja e shpenzimeve kapitale. Kjo përfaqëson punën fillestare të instalimit të një transformatori të ri 150MVA në TS Prizreni 2 ose Prishtina 4. Variacioni nuk do të ndryshonte të hyrat totale të lejuara për 2008 dhe nuk do të ndryshonte ngarkesat e propozuara të transmisionit.

Përgjigjet e ZRRE-së ndaj secilit koment janë paraqitur më poshtë.

ZRRE-ja nuk sheh asnjë arsye/nejvojë për të ndryshuar propozimet e saj preliminare sa u përket ngarkesave të transmisionit bazuar në këto komente.

#### **4.1 Koha e rishikimit të tarifave**

ZRRE-ja pajtohet se parashikueshmëria dhe konsistenca në kohën (periudhë kohore) e rishikimit të tarifave është me rëndësi për të krijuar një kornizë stabile rregulatore. Megjithatë, duket se ka paqëndrueshmëri në këtë koment të KOSTT-it dhe kërkesës së tij që në të ardhmen vendimet mbi të hyrat e lejuara dhe tarifat aplikohen për një periudhë duke filluar nga 1 Janari në vend se nga 1 Prilli sipas rishikimit aktual. Implementimi i kërkesës së KOSTT-it do të nënkuptonte se :

- Ngarkesat e transmisionit që do të hynin në fuqi me 1 Prill 2008 do të mbesin të pandryshuara deri me 1 Janar 2010 (d.m.th pas 21 muajve)
- Ngarkesat e transmisionit që hyjnë në fuqi më 1 Prill 2008 janë potencialisht të përshtatura me 1 Janar 2009 (d.m.th pas 9 muajsh)

Kjo do të nënkuptonte një ndryshim signifikante në orarin e rishikimit të tarifave, nëse ZRRE tani ka aprovuar një princip të përgjithshëm që rishikimet të bëhen në intervale 12 muajshe. Kjo e fundit do të dukej si konflikt me kushtet e paraqitura nga Ligji mbi Energjinë Elektrike që ngarkesat e transmisionit të propozohen një herë në 12 muaj (Neni 25.2).

ZRRE-ja pajtohet që do të ishte e dëshirueshme për të radhitur periudhën në të cilën të hyrat e lejuara janë përcaktuar nën rishikimet tarifore më vitin financiar të Kosovës. Megjithatë nuk është e qartë nga propozimet se si mund të arrihet kjo më së miri.

ZRRE propozon që të konsultohet me tutje me KEK-un, KOSTT-in dhe palët e tjera të interesuara në këto çështje.

#### **4.2 Bashkërendimi i të hyrave**

ZRRE-ja pranon se nuk është aplikuar asnjë bashkërendim për diferencat në të hyrat e KOSTT-it që kanë rezultuar nga diferencat mes vëllimeve aktuale dhe atyre të parashikuara për transmetim si dhe kërkesës gjatë pikut në të hyrat e lejuara për KOSTT-in për 2008.

ZRRE-ja vlerëson që në 2007-tën, të hyrat aktuale të KOSTT-it tejkalojnë të hyrat e lejuara të miratuara të llogaritura në bazë të vitit kalendarik<sup>4</sup>. Aplikimi i kësaj përshtatjeje nënkupton se të hyrat e lejuara për 2009 duhet të reduktohen më tutje për këtë shumë.

#### 4.3 Kostoja e ekuivalencës së kapitalit

ZRRE pajtohet që mund të ketë arsye se pse kostoja e kapitalit do të ndryshonte mes KEK-ut dhe KOSTT-it (psh. për shkak të profilit ndryshues të riskut të shoqëruar me aktivitetet e dy firmave). ZRRE vëren se KOSTT-i gjatë këtij rishikimi tarifor nuk ka prezantuar dëshmi që tregojnë se një dallim i tillë mund të ekzistojë. Megjithatë, ZRRE-ja është e gatshme të marrë në konsideratë paraqitjet që argumentojnë në favor të ndryshueshmërisë së kostonë së kapitalit si pjesë e rishikimit të më pastajmë tarifor.

#### 4.4 Përshtatja kompozicionit të të hyrave të lejuara

Ndryshimet e propozuara nga KOSTT-i ndaj kompozicionit të të hyrave të lejuara në 2008 janë paraqitur më poshtë.

**Tabela 1: Ndryshimet e propozuara nga KOSTT-i për kompozicionin e të hyrave të lejuara**

€000S	
Shpenzimet operative – Mirëmbajtja	-286.2
Shpenzimet kapitale	+3,476.6
<i>qe rezultojnë në</i>	
Ndryshim në lejimet e amortizimit	+49.7
Ndryshim në kthimin e lejuar	+236.5
<b>Ndryshimi Neto në të hyrat e lejuara</b>	<b>0.0</b>

ZRRE-ja ka dy paqartësi lidhur me ndryshimet e propozuara:

- Nuk është e qartë se a është bërë propozimi i KOSTT-it për të zëvendësuar shpenzimet e mirëmbajtjes me shpenzimet kapitale për arsye se:
  - KOSTT-i konsideron që shpenzimet e propozuara kapitale janë po aq efektive si shpenzimet e lejuara më parë të mirëmbajtjes gjatë përmbushjes së kërkesave të besueshmërisë së rrjetit dhe standardeve të sigurisë, apo

<sup>4</sup> Krahasimi i të hyrave nën ngarkesat e transmissioinit prej 1 Majit 2007 duke përdorur kërkesën aktuale dhe të parashikuar si dhe energjinë e transmetuar për 12 muaj që nga 1 Janari 2007 deri 31 Dhjetor 2007.

- KOSTT-i e konsideron si të mundshme reduktimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes në nivelet e kërkuara më parë dhe të pranuar nga ZRRE-ja pa ndikuar negativisht në besueshmërinë/qëndrueshmërinë dhe sigurinë e rrjetit.
- KOSTT-i në komentet e tij të paraqitur ZRRE-së, deklaron se i pranon përshtatjet e propozuara nga ZRRE-ja të të hyrave të lejuara për shpenzimet kapitale të pafinancuara. Sipas kësaj përshtatje, shpenzimet e propozuara kapitale për të cilat financimi i jashtëm nga burimet qeveritare apo të donatorëve nuk është identifikuar, janë përjashtuar nga përlllogaritja e të hyrave për 2008. Megjithatë, kërkesa e KOSTT-it për të përshtatur kompozicionin e të hyrave të lejuara duket e kundërt me këtë princip me përfshirjen e shpenzimeve kapitale për të cilat asnjë burim i jashtëm i financimit nuk është identifikuar ende.

ZRRE-ja mbështet përpjekjet e KOSTT-it për të filluar financimin e investimeve të reja nga burimet interne dhe huat komerciale në të cilat do të kontribuojnë përshtatjet e propozuara dhe kompozicioni i të hyrave të lejuara. Megjithatë, ZRRE-ja nuk konsideron se duhet të pranohet ky propozim për këtë rishikim të çmimeve:

- Nuk është e mundur të përcaktohet nëse ndryshimet e propozuara ndaj kompozicionit të të hyrave të lejuara do të kishin efekt të dëmshëm në rrjetin e transmissioinit për shkak të shpenzimeve të reduktuara të mirëmbajtjes.
- Ndryshimet e propozuara duket të jenë të kundërta me principet e lidhura me shpenzimet kapitale të pafinancuara të themeluara nga ZRRE-ja dhe pranuar nga KOSTT-i për këtë rishikim të çmimeve.

## **5 Komentet e SHUKOS-it**

Në paraqitjen e tyre, SHUKOS-i ka shprehur brengosjen lidhur me ndikimin e rritjes së tarifave mbi anëtarët e tij. SHUKOS-i deklaron se:

- Ujësjellësit tanimë janë duke përjetuar vështirësi në mbulimin e kostos operative për shkak të mungesës së përkrahjes institucionale për reduktimet e humbjeve dhe rritjeve të normave të arkëtimit.
- Energjia elektrike llogaritet të jetë rreth 25% e shpenzimeve operative të ujësjellësve.
- Kostoja e energjisë elektrike është rritur për 20-25% gjatë 2007-tës si rezultat i tarifave të reja të vendosura në 2007-tën.
- Propozimet preliminare të tarifave do të rezultojnë në një shtesë prej 5-6% të kostos së energjisë elektrike për ujësjellësit.
- Përveç nëse ujësjellësit lejohen të revidojnë tarifat e tyre (të cilat janë të rregulluara nga Zyra e Rregullatorit të Ujit dhe Mbeturinave, ZRRUM-it) për të marrë në konsideratë koston e rritur të energjisë elektrike, zbatueshmëria dhe mundësia financiare për të mbajtur furnizimin e konsumatorëve me ujë është e rrezikuar.

SHUKOS-i propozon që zgjidhja e këtij problemi është krijimi i një kategorie të re për ujësjellësit dhe mos rritja e tarifave për këtë kategori.

Parimi i përgjithshëm në definimin e kategorive tarifore është që ato duhet të përmbajnë së bashku konsumatorë me karakteristika të njëjta (profilin e ngarkesës dhe nivelin e tensionit të furnizimit). Kategoritë tarifore nuk duhet të jenë të dizajnuara për të favorizuar një grup të posaçëm të konsumatorëve ndaj të tjerëve duke u ofruar tarifa më të ulëta kur ato nuk mund të arsyetohen më dallimet në kostot e furnizimit mes konsumatorëve.

Në mënyrë që ujësjellësit të klasifikohen si një kategori e ndarë tarifore duhet megjithatë të demonstronhet që profili i tyre i ngarkesës është i veçantë në raport me konsumatorët tjerë industrial dhe komercial në çdo nivel tensionesh. Nëse ujësjellësit konsiderojnë këtë të jetë e vërtetë, procedurat përkatëse që duhet ndjekur do të ishin diskutimi i çështjes me KEK-un i cili është përgjegjës për ti propozuar për aprovim ndryshimet në kategoritë tarifore nga ZRRE-ja .

Në rast se ujësjellësit janë në gjendje të demonstronjë që karakteristikat e tyre arsyetojnë themelimin e një kategorie të veçantë tarifore, nuk do të thotë,që si rrjedhojë tarifat për këtë kategori nuk duhet të ngritën kur kostoja e furnizimit me energji elektrike rritet. Vendimet mbi tarifat e rregulluara te ujit dhe faktet se a janë përshtatur ato për të marrë në konsiderim koston e rritur të energjisë elektrike duhet të merren nga ZRRUM-i. Nuk do të ishte reale që ZRRE-ja të mos parashikojë që ZRRUM-i do të përshtatë tarifat e rregulluara të ujit dhe ti përgjigjet duke mos aprovuar tarifat e rritura të energjisë elektrike për ujësjellësit.

ZRRE-ja nuk sheh ndonjë nevojë të ndryshimit të propozimit preliminar tarifar për të marrë parasysh këto komente. Megjithatë ZRRE-ja është e gatshme të bashkëpunojë me SHUKOS-in dhe KEK-un për të shqyrtuar se a është e drejtë vendosja e kategorisë tarifore të veçantë për ujësjellësit bazuar në karakteristikat e kërkesës së tyre.

## **6 Komentet e Shoqatës së Mullisëve të Kosovës**

Asociacioni i Mullisëve te Kosovës ka shprehur brengosjen mbi ndikimet e rritjes së tarifave në zbatueshmërinë e industrisë së miellit. Në veçanti, Asociacioni deklaron se :

- Kategoria tarifore e aplikuar ndaj mullisëve me trafo-stacionet e tyre dhe njehsimin grupor është ndërruar dy herë. Më parë këta konsumatorë të bashkuar kanë qenë të kualifikuar për tarifat energjike të caktuara për 50% të nivelit të aplikueshëm për konsumatorët shtëpiak për shkak të konsumit të tyre të lartë. Si rezultat e ndryshimit të kategorisë, tarifat e energjisë janë rritur për 200% për këta konsumatorë.
- Këto ndryshime të kategorisë janë bërë pa u konsultuar me industrinë e miellit.

ZRRE vlerëson brengosjen e Asociacionit të Mullisëve. Megjithatë ZRRE vëren se kategoritë tarifore të aplikuara aktualisht janë të njëjtat me ato të aplikuara para 2007-tës dhe se propozimet preliminare të ZRRE-së për 2008 nuk përmbajnë përshtatje në kategoritë e tilla. Për këtë arsye çdo ndryshim në kategorinë tarifore të aplikuar ndaj mullisëve do të dukej të jetë si pasojë e ri-alokimit të këtyre konsumatorëve nga një kategori në tjetrën nga KEK-u. Një konsultim adekuat për një ri-alokim të tillë është përgjegjësi e KEK-ut.

ZRRE-ja nuk sheh asnjë arsye për të ndryshuar propozimet preliminare tarifore të saj për shkak të këtyre komenteve. Megjithatë, ZRRE është në dispozicion për diskutim të detajeve lidhur me brengat e asociacionit të Mullisëve sa i përket ri-alokimit të mullinjve mes kategorive tarifore dhe të hetojë çështjen më tutje nëse ka nevojë.

## **7 Shkresë nga MEM-i**

ZRRE-ja ka pranuar një shkresë që paraqet qëndrimin e MEM-it mbi principet të cilat Qeveria i konsideron se duhet të merren parasysh gjatë rishikimit të tarifave. Kjo shkresë është bashkangjitur në një letër dërguar ZRRE-së, KEK-ut dhe KOSTT-it. Vetëm ato pjesë të lidhura me vendimmarrjen e ZRRE-së janë paraqitur në këtë shkresë.

Instrukcionet me shkrim thonë se:

- Tarifat duhet të reflektojnë kostot e furnizimit dhe të eliminojnë ndër-subvencionimet mes kategorive të konsumatorëve. Megjithatë, rritjet e tarifave për konsumatorët shtëpiak duhet të jenë graduale dhe të marrin në konsiderim çështjen e mundësisë paguese.
- Tarifat për bllokun e parë të konsumit për konsumatorët shtëpiak (deri 200kWh/muaj) duhet të mbesin të pandryshuara ose të rriten në masë më të vogël se tarifat tjera. Tarifat për bllokun e dytë të konsumit (200-600kWh në muaj) duhet të reflektojnë koston e prodhimit nacional të energjisë por nëse ka mundësi jo koston e furnizimit nga importi.

ZRRE konsideron që rregullatorët duhet të marrin në konsiderim politikat qeveritare aty ku janë të përputhshme me detyrimet e tyre ligjore.

Në bazë të kësaj, ZRRE-ja konsideron që është e nevojshme që në propozimet e saj të reflektohen çështjet e përmendura nga qeveria mbi mundësinë paguese të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët më të varfër shtëpiak. ZRRE-ja propozon që të bëjë një gjë të tillë duke rritur tarifat e energjisë për bllokun e parë të konsumit për konsumatorët shtëpiak ( kategoritë tarifore 5,6 ) në një normë më të ulët prej 2.5% në vend të rritjes 5%-she që ishte në propozimet preliminare të ZRRE-së.

Rritjen aktuale mesatare në faturat e rrymës për konsumatorët shtëpiak do të ishin pak më të ulëta se ky nivel pasi ngarkesat fikse të konsumatorëve nuk do të rriteshin.

Tarifat e energjisë dhe kërkesës për konsumatorët tjerë përfshirë edhe blloqet e konsumit më të lartë për konsumatorët shtëpiak do të rriten për 5 % sipas propozimeve preliminare të ZRRE-së. Duke marrë parasysh pritjet e ZRRE-së se KEK-u është në gjendje që të mbajë humbjet teknike të distribucionit në nivelin e 2007-tës, projektimi i ZRRE-së është se KEK-u do të vazhdojë të mbulojë të hyrat e tij të lejuara për 2008 në tërësi, pas rritjes së përshtatur tarifore.

## **8 Draft propozimi final tarifor i ZRRE-së**

### **8.1 Tarifat me pakicë**

Siç përshkruhen amendamentet në pjesën paraprake të kësaj shkrese, gjatë rishikimit intern të mëtutjeshëm të propozimeve preliminare, ZRRE-ja gjithashtu ka vërejtur nevojën e përshtatjes së tarifave të energjisë reaktive të aplikuara ndaj konsumatorëve në kategoritë tarifore 1, 2 dhe 3.

Në shkresën konsultative , ZRRE-ja ka identifikuar çështjet që ngarkesat aktuale të energjisë reaktive për konsumatorët e 35kV dhe 10kV (kategoritë tarifore 1 dhe 2) janë jashtëzakonisht të ulëta dhe nuk duken se e reflektojnë koston. Propozimet preliminare të ZRRE-së kanë qenë që të adresohen këto çështje duke harmonizuar ngarkesat e energjisë reaktive për të gjitha kategoritë tarifore në nivelin e aplikuar për konsumatorët e 0.4kV me njehsim të energjisë reaktive (kategoria tarifore 3) prej €c1.53/kVArh. ZRRE-ja ka vërejtur në komentet e saj se KEK-u është pajtuar me këtë qasje duke identifikuar njëkohësisht nevojën për punë të mëtutjeshme në përcaktimin e koston aktuale te furnizimit me energji reaktive për këta konsumatorë.

Rishikimi i mëtejshëm nga ZRRE-ja ka treguar se propozimet e saj preliminare sjellin një mbimbullim sinjifikant të koston së distribucionit të KEK-ut. Të hyrat e arkëtuara nga ngarkesat e energjisë reaktive do të ishin të mëdha dhe do të kishte nevojë të pasohen nga reduktime në ngarkesat tjera<sup>5</sup>.

ZRRE-ja megjithatë ka ndryshuar/modifikuar propozimet e saj preliminare mbi tarifatat e energjisë reaktive. Propozimet e ndryshuara/modifikuar janë në vijim:

- Një ngarkesë uniforme e energjisë reaktive do të aplikohet për të gjithë konsumatorët e kualifikuar për këtë ngarkesë (kategoritë tarifore 1,2 dhe 3).
- Ngarkesa uniforme reaktive do të caktohet të jetë €co.64/kVArh.Ky nivel e anashkalon problemin e mbi- kthimit të të hyrave të lejuara për distribucionin e KEK-ut.

Draft propozimi final rezultues i ZRRE-së mbi tarifatat e rregulluara me pakice për 2008 duke marrë parasysh normat e përshtatura të rritjes për tarifatat shtëpiake dhe tarifatat e energjisë reaktive të përshkuara sipër janë paraqitur, në vijim.

---

<sup>5</sup> Nëse ngarkesat e energjisë reaktive nuk reflektojnë koston por këtë e bëjnë ngarkesat tjera, atëherë reduktimi i këtyre ngarkesave për te kompensuar mbimbullimin e të hyrave te lejuara do te keqësonte çështjen e reflektimit të e kostove në tërësi.

**Tabela 2: Tarifat me pakicë të propozuara nga ZRRE-ja**

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Ekzistues e		Propozuar nga ZRrE për vitin 2008	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët	Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		981.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		519.00	519.00	545.00	545.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.03	1.78	6.33	1.87
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.50	1.47	2.63	1.54
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVAh		0.00	0.00	0.00	0.00
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		30.00		130.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		540.00	540.00	567.00	567.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.30	2.73	6.62	2.87
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.33	2.47	3.50	2.59
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVAh		0.04	0.04	0.64	0.64
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		54.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		466.00	466.00	489.00	489.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.07	3.15	7.42	3.31
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.81	2.87	4.00	3.01
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVAh		0.32	0.32	0.64	0.64
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		29.00		30.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		270.00	270.00	284.00	284.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.85	4.36	8.24	4.58
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.95	4.11	5.20	4.32
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVAh		1.53	1.53	0.64	0.64
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		34.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		0.00	0.00	0.00	0.00
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	9.68	6.26	10.16	6.57
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	11.64	7.63	12.22	8.01
			€/kWh	Tarifa e ulët	5.82	3.81	6.11	4.00
5	0.4kV matësi 2-tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00		24.00	
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.42	3.17	4.53	3.25
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.21	1.58	2.27	1.62
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	5.97	4.28	6.27	4.49
	€/kWh	Tarifa e ulët	2.99	2.14	3.14	2.25		
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	8.67	6.21	9.10	6.52
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.33	3.11	4.55	3.27
6	0.4kV matësi 1-tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00		24.00	
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifa e vetme	3.94	2.82	4.04	2.89
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifa e vetme	5.32	3.81	5.59	4.00
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë)	€/kWh	Tarifa e vetme	7.72	5.53	8.11	5.81
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar <200kWh/muaj	€/konsumator/muaj		20.00		21.00	
		Konsumi i vlerësuar 200-600kWh/muaj	€/konsumator/muaj		36.00		38.00	
		Konsumi i vlerësuar >600kWh/muaj	€/konsumator/muaj		61.00		64.00	
8	Ndrërimi publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		34.00	
		Energjia Aktive (P), për konsum:	€/kWh	Tarifa e vetme	7.82	7.82	8.21	8.21

Tarifa e lartë aplikohet prej 07:00 - 22:00 e hënë - e shtunë gjatë sezonës së lartë dhe 08:00 - 23:00 e hënë - e shtunë gjatë sezonës së ulët

## 8.2 Ngarkesat e transmisionit

ZRRE-ja nuk ka identifikuar ndonjë ndryshim të kërkuar në propozimet e saj preliminare mbi ngarkesat e transmisionit të aplikuara nga 1 prilli 2008. Këto megjithatë mbesin të pandryshuara nga ato të paraqitura në shkresën konsultative. Ngarkesat e propozuara të transmisionit janë paraqitur në vijim.

**Tabela 3: Ngarkesat e transmisionit të propozuara nga ZRRE-ja**

Grupi tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementet tarifore	Njësia	Ekzistuese	Të propozuar nga ZRrE për vitin 2008
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	0.000	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.834	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	0.000	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.834	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	0.000	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.305	0.289
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	3.025	3.618
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.834	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	6.792	7.878
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.834	0.853
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013